

KONTRIBUTI I MITRUSH KUTELIT PËR POEZINË POPULLORE

Jahir AHMETI
Prishtinë

KUD: 891-983:389.8
Punim studimor

Marrë për botim më 25.XII.1996

Përmbajtja e shkurtër: Në këtë punim trajtohet kontributi i Mitrush Kutelit për poezinë popullore, i cili në këtë fushë shtrihet në tri rrafshje. Në rrafshin e parë, mbledhës dhe publikues i poezisë popullore; në rrafshin e dytë, studiues i vlerave të kësaj poezie dhe në rrafshin e tretë, rikrijues dhe shfrytëzues i spikatur i motiveve të poezisë popullore.

Rëndësia e krijimtarisë së Mitrush Kutelit në letërsinë shqipe është e madhe dhe shumëdimensionale. Deri në decenien e fundit për të është shkruar dhe folur pak. Pra, nuk i është dhënë vendi i merituar në asnjërën nga fushat e krijimtarisë, në të cilat, ai dha kontributin e vet të çmuar e të respektuar. Interesimet e tij krijuese, Mitrush Kuteli i kishte shtrirë në fushën e artit e të letërsisë, si prozator e si poet, si përkthyes e si kritik letrar, si rikrijues i legendave, i baladave e i përrallave e si folklorist, por edhe si studiues i shkencave ekonomike. Në të gjitha këto fusha, me kontributin e tij të pamohueshëm, la gjurmë të rëndësishme. Mirëpo, për disa fusha të krijimtarisë së tij, deri sot, janë dhënë vetëm informacione të përcipta, se është marrë me çështje të ndryshme, ndërkaq, as lexuesve e as studiuesve ende nuk u është bërë e njohur dhe nuk u është ofruar komplete krijimtaria e gjithmbarshme e tij. Kështu, mund të thuhet se edhe ndërmarrja më serioze deri tash në këtë drejtim, siç është rasti i botimit të pesë vëllimeve në Tiranë, më 1990, nuk e prezenton si e sa duhet as prodhimtarinë e tij letrare e as kritikën për të.

Çështja që shtrohet në kumtesën time është: Kontributi i Kutelit për poezinë popullore, i cili në këtë fushë, shtrihet në tri rrafshje:

1. Mbledhës dhe publikues i poezisë popullore;
2. Studiues i vlerave të kësaj poezie dhe
3. Rikrijimi me mjeshtri dhe risemantizimi i motiveve të poezisë popullore në prozë.

Për sa i përket çështjes së parë, dihet se Kuteli la pas vete një përmbledhje të rëndësishme me materiale folklorike, të titulluar *Këngë dhe brithma nga qyteti i djegur*.¹ Ky libër është mjaft i pasur me materialet folklorike që përmban, por edhe me shënimet biografike për këngëtarët, si dhe me të dhënat e tjera për këngët, për ngjarjet dhe për personazhet. Autori, librin e organizon në nëntë cikle, duke i ndarë krijimet poetike popullore sipas kriterëve të qëndrueshme shkencore: I. *Këngë vaji*; II. *Këngë pleqërishte*; III. *Këngë lufte e trimërije*; IV. *Këngë dashurije*; V. *Këngë dasme a. rituale, b. për gas c. për gas e qesëndi*; VI. *Këngë pashke*; VII. *Këngë për lule edhe këngë llazore*; VIII. *Këngë të ndryshme* dhe IX. *Brithma dhe brithma qesëndije dhe të ndryshme*.

Mbledhja e folklorit për Kutelin, nuk ishte e çastit, por, ishte prirje dhe pasion që e shoqëroi tërë jetën. Ngase siç thotë vetë, *Folklori ka qenë ushqimi shpirtëror i përhershëm kur ndodhesha në mërgim. Atje kam filluar të mbledh folklor midis shqiptarëve të mërguar*.² Këtë veprimtari ai e vazhonte krahas angazhimeve të tjera edhe në Shqipëri, ku, siç thotë vetë: *Më vonë mblodha 80 përralla dhe 140 këngë popullore, të cilat, mjerisht mbetën të pabotuara*.³ Po ashtu, sipas të dhënave që hasim në një shënim tjetër të autorit, gjatë qëndrimit të tij në mërgim, kishte mbledhur *një vëllim me afro 200 këngë popullore molldavishte*,⁴ të cilin e kishte lënë për botim në Bukuresht, në shtator të vitit 1942. Vëllimi në fjalë nuk dihet se a është botuar ndonjëherë apo jo.

Mbledhja e folklorit Kutelit i shërbente dhe i ndihmonte shumë edhe për pasurimin e fjalorit në fushën e krijimtarisë letrare, ngase siç shprehet: *duke mbledhur këto këngë, ndiqja qëllimin e plotësimin të frazeologjisë që më duhej për shkrimet e mija letrare*.⁵ Nga kjo shihet qartë se, ashtu siç vërehet edhe në mbarë krijimtarinë e tij, Kuteli me vetëdije të plotë e mbështeti artin e vet letrar mbi bazën e shëndoshë të folklorit. Prandaj, pa dyshim, mund të thuhet se është njëri nga shkrimtarët tanë, që më së shumti, në mënyrë origjinale dhe me sukses arriti të shfrytëzojë formën dhe frymën popullore në gjithë krijimtarinë e tij letrare.

Në përmbledhjen folklorike *Këngë dhe brithma nga qyteti i djegur*, Kuteli arrin të na prezantojë, përveç tjerash, edhe krijime

¹ *Këngë dhe brithma nga qyteti i djegur*, i mblodhi M. K u t e l i, botim i mbledhësit, Tiranë, 1944.

² *Kujtesa*, botuar në "Jeta e re", 5-1995, revistë letrare, Prishtinë, 1995, f. 674.

³ Po aty, f. 675.

⁴ *Këngë dhe brithma nga qyteti i djegur*, Tiranë, 1944, f. 7.

⁵ Po aty, f. 8.

antologjike të poezisë popullore, siç janë këngët me elemente baladike: *Mbeçë, more shokë, mbeçë, O shokë, s'ma dini hallë, Fryn veriu në mal të thatë, Ç'u nis plaku edhe djali, Kënga e Ymer Agës* etj. Edhe pse Kuteli i radhit në grupe të ndryshme, këto krijime me të gjitha komponentet e strukturës poetike i përkasin llojit të baladës, e cila, si lloj epiko lirik i krijimtarisë popullore, shquhet për mundësinë sintetizuese të fatit të individit e të kolektivit, fat i cili është i kushtëzuar nga rrethanat e caktuara shoqërore të kohës, të cilat pashmangshëm krijojnë konfliktin dhe momentin tragjik të përjetuar fuqishëm nga heronjtë e baladave. Me emërtimin *Këngë pleqërishte*, Kuteli, *shënon baladën popullore si këngë të lashtë, qoftë për nga përmbajtja, qoftë edhe sa i përket strukturës poetike dhe muzikore.*⁶

Lirizmi i fuqishëm, figuracioni i qëlluar siç janë: epiteti, krahasimi, gradacioni etj., gjuha metaforike dhe simbolika e botës rurale dhe situatat e ndryshme që paraqesin relacionet dashuri-punë, dashuri-mërgim, pengesat e ndryshme në realizimin e dashurisë etj., paraqesin vlera të pamohueshme artistike të këngëve të dashurisë dhe të dasmës, të përfshira në librin e Kutelit. Po ashtu, përveç vlerave letrare, që përmbajnë materialet, Kuteli na ofron edhe mjaft shënime e të dhëna të tjera etnografike, me çka ia shquan vlerën letrare dhe shkencore librit në fjalë.

Mendimit kritik për poezinë popullore dhe vlerat e saj letrare e artistike, Kuteli nuk i ka dhënë shumë hapësirë në botimet e tij. Në vështrimin me titull *Vendet e largimit në këngët popullore*⁷ dhe në shënimin *Këngët i sjell era...*⁸, ai shpreh mendime të vlefshme dhe interesante, jo aq për vlerat e këngës si krijim artistik, sa për impresionet dhe asociacionet që i zgjonin tekstet e këngëve popullore. Jetën në mërgim, Kuteli e jetoj dhe e përjetoj vetë, prandaj, nuk është e rastësishtme që ai, në radhë të parë, u mor me vlerat letrare, apo më drejtë, shquan më tepër një segment të vlerës së përgjithshme letrare të këngëve të mërgimit, siç është gjeografia e këtyre këngëve. Jeta e tij prej mërgimtari, gjithsesi, ndikoi tek ai që lloji i këngëve të mërgimit të përjetohet dhe të njihet më për së afërmi. Kurbeti, si në rrëfimet, ashtu edhe në trajtimet teoriko - letrare, vështrohet si një e keqe e madhe me pasoja të rënda shoqërore. Kur bën fjalë për *perandorinë*, siç e quan ai, e vendeve që përmenden në këngët tona popullore, vëren se kësaj

⁶ Dr. Sadri Fetiu, *Poetika e baladës popullore shqiptare*, IAP, Prishtinë, 1987, f. 28.

⁷ Botuar në "*Shqipëria e re*", Konstancë, 10 janar 1933, ribotuar në *Vepra*, 5, Tiranë, 1990, faqe 176-188.

⁸ Botuar si parathënie në vëllimin, *Këngë dhe brithma nga qyteti i djegur*, Tiranë, 1944.

perandorie i takojnë pesë kontinente, që është e pashembulltë në folklorin e popujve të tjerë të Ballkanit. *Begatia horizontale* e këngëve tona të mërgimit, sipas Kutelit, *përbën edhe njërin nga elementet e origjinalitetit të muzës sonë popullore.*⁹ Shtrirja kaq e madhe horizontale e shqiptarëve, për të cilën dëshmojnë këngët, e shtyjnë atë të hulumtojë edhe shkaqet që e nxisin një shkapërderdhje të tillë të etnisë sonë, e cila, për fat të keq, po vazhdon edhe sot, me përmasa po aq tragjike dhe me prirje dhe mundësi të shtrirjes edhe më të madhe horizontale, të cilën e ndihmon niveli i sotëm i zhvillimit teknik për transport. Faktorët edhe sot janë po ata që konstatonte Kuteli para gjashtë deceniesh: politik, shoqëror dhe ekonomik.

Përmes një analize të ngjeshur faktografike, duke shfrytëzuar metodën e krahasimit, por edhe si njohës i mirë i rrethanave në Ballkan e më gjerë dhe i folklorit të popujve të Ballkanit, Kuteli konstaton se, popujt e tjerë u kanë kënduar vendeve të huaja *më tepër nga tevatyrat, domethënë nga sa kanë dëgjuar dhe fare pak nga sa kanë parë. Shqiptari, përkundrazi, e këndon Misirin në Misir branda, Abisinin në Abisini, Moskovin në Rusi etj.*¹⁰ Kështu që, këngët e mërgimit të cilat janë shumë më të rralla tek popujt e tjerë, janë të ngarkuara shumëherë me artificializëm, *me ide të mbjella dhe jo të mbira vetë, sikundër është lulja e egër e muzës shqiptare.*¹¹

Meqë kënga është pjesë e shpirtit të një populli, e shkrirë në vargje, ajo s'ka si të ndahet, s'ka si të copëtohet. Rrëfimi prekës i Nadias në Ukrainë për tekstin e një kënge që e kishte mësuar nga goja e vashave të përtejkuqirit, i zgjon Kutelit asociacione dhe përjetime të fuqishme, për fatin tragjik të popullit të vet, të ndarë me kutij. Në shenjë kundërshtimi të një ndarjeje të tillë, ai thotë se: *Kënga s'ka kufire që t'a ndalojnë. Ajo lindet diku edhe, në qoftë se përmban brenda saj do-një thërrime arti të vërtetë, shkon gojë pas goje, në krahët e erës.*¹²

Ritregimi i motiveve të poezisë popullore në prozë dhe ndërlidhja e vargjeve të këngëve me motivet e tregimeve e shquajnë Kutelin si tregimtar, veçanërisht origjinal në letërsinë tonë. Në prozën e tij, kënga popullore ka luajtur një rol të rëndësishëm, dhe shpeshherë, pothuajse vendimtar, në formimin dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare të personazheve. Nën ndikimin e fuqishëm të këngës popullore shohim tek bëhen kthesa të mëdha vetëdijësimi tek Sylejman Sylejmani, personazh i

⁹ *Vepra*, 5, Tiranë, 1990, f. 177.

¹⁰ Po aty, f. 177.

¹¹ Po aty, f. 178.

¹² *Këngë dhe brithma...*, vep. e cit., f. 8.

tregimit *Gjonomadh dhe Gjatollinj*. Po ashtu, Theofil Kostori, formohet si personalitet njerëzor dhe si personazh kompleks artistik, nën ndikimin e traditës së pasur poetike popullore të vendlindjes. Me vargjet e këngëve popullore, duke filluar nga ato të fëmijëve, të cilat autori i quan brithma, atyre të motmotit, të dashurisë e të dasmës e deri te këngët historike, baladat e legjendat, autori, duke i vënë në gojën e personazheve, rikonstrukton të gjallë vizionin e atdheut. Ja si e fillon rrëfimin e tij *Fije nga jeta e Theofil Kostorit*:

*Kjo që lëcitni, është jeta ime.
Vetë e rrojta, vetë e shkrojta.
Me gazet e saj, me helmet e saj.
Të gjitha të perënduara sot e kaqe të larguara, sa më
duket sikur s'patën genë kurrë...
Po duke i shkruar tani, në vitin tridhjetë e shtatë të jetës, i
rrojta edhe një herë.
Dhe qesha, dhe qava...¹³*

Kuteli pas këtij lloj prologu të tregimit, përmes gojës së personazhit kryesor, Theofilit, ndërftoi mes pasuseve të kësaj proze, hiç më pak se 133 vargje, të vjela nga këngë të ndryshme popullore.

Vargjet e këngëve popullore, aq të shpeshta në prozën e Kutelit, nuk përdoren vetëm për të bërë dekor, por, përdoren me funksion artistik dhe lidhen natyrshëm dhe bindshëm me përmbajtjen e tregimeve dhe veprimet e personazheve. Po ashtu, është me rëndësi të theksohet fakti se, vargjet e këngëve që ndërlidh Kuteli në tregimet e tij, nuk janë improvizime të autorit, por janë këngë të mirëfillta popullore, të cilat, ai ose i ka mbledhur vetë ose i ka marrë nga përmbledhjet e ndryshme folklorike:

*Malet e Gramozit qajnë
Zi të madhe ata mbajnë,
Për Ganinë që e vranë...
Sali Butkës van' i thanë:
- Ty Ganin ta zun' t' gjallë...
- Mos ma thoni këtë fjalë
Se Ganin ma kanë vranë...
Sali Butka shtron rakinë
E me lot e qan Ganinë...¹⁴*

¹³ Mitrush Kuteli, *Vepra*, 2, "Fije nga jeta e Theofil Kostorit", Tiranë, 1990, f. 68.

¹⁴ Mitrush Kuteli, *Vepra*, 1, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990, f. 282.

Gani Butka nga Kolonja, patriot dhe luftëtar trim, i cili u vra në Pogradec në korrik 1914, komandant i një çete luftëtarësh, është bir i Sali Butkës, i cili po ashtu, u shqua në luftë për mbrojtjen e tokave shqiptare nga synimet aneksioniste të shovinistëve fqinjë. Po këto vargje të kësaj kënge, që Kuteli i shfrytëzon në novelën e tij mjaft të realizuar *Qetësi përpara fërtyme*, i hasim të botuara edhe si këngë popullore:

*Malet e Gramozit qajnë,
një zi të madhe po mbajnë,
për Ganinë kapedanë.
Ata male kush i shkelte?
Veç Ganiu me shokë delte.
Sali Butkës van' i thanë:
- Sali, Ganinë ta vranë!
- Mos e thoni atë fjalë
se Ganin' e kam gjallë.
Saliu e shtroi rakinë,
fshtolli gjithë miqësinë,
me lot po qante Ganinë.
Gur' e drurë po vajtojnë,
Gani Butkën e kërkojnë.¹⁵*

Ndryshimet e vogëla që vërehen në tekstin e Kutelit mund të supozohet se, teksti ose është marrë nga një variantë tjetër e këngës, ose, ai i ka bërë për efekte të caktuara estetike.

Kuteli, me një aftësi që të mahnit, ka arritur t'i trajtojë artistikisht si temat që shquhen me një frymëmarrje të gjerë poetike, ashtu edhe temat, t'i quajmë kushtimisht, të imëta. Mirëpo, në të gjitha trajtimet e tij letrare, përbërësit e veprës marrin dimensione me rëndësi dhe vlera të veçanta artistike dhe këtë vlerë ai ua shton edhe me origjinalitetin e qasjes. Idetë e veprës së tij janë të qarta dhe bindëse. Ai edhe kur bën trupëzimin e elementeve mitologjike, qoftë në krijimet origjinale, qoftë në ritregimet e baladave e të legjendave popullore, që janë vërtet riletarizime, e bën bindshëm dhe me funksion artistik, duke i ofruar kështu lexuesit mundësinë që të përjetojë këndshëm kumtimin e veprës së tij. Theksi i kumtimit të veprës së Kutelit, gjithëherë vihet në vrytytet e njerëzve të vendit të tij, të cilët janë në lëvizje të përhershme, të ngarkuar me probleme, në situata nga më të ndryshmet por, që dinë ta çmojnë jetën dhe ta gëzojnë atë. Në këtë drejtim, kënga popullore është ajo që luan rol

¹⁵ *Këngë popullore nga rrethi i Pogradecit*, përgatitur nga Tomor Starova, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1987, f. 53.

dhe ka funksion shumëdimensional në veprën e Kutelit. Ngase përmes këngës, në të shumtën e rasteve, shprehet disponimi i personazheve të veprës së tij.

Që Kuteli e donte dhe e çmonte krijimtarinë poetike popullore s'ka dyshim. Ai këtë e dëshmon bindshëm në gjithë veprën e tij. Madje, jo vetëm në krijimet e tij letrare artistike, por edhe në kujtimet dhe udhëpërshkrimet e ndryshme. Udhëpërshkrimi *Në Prizren midis të gjallëve e të vdekurve*, është edhe një e dhënë e fuqishme për mendimin e sipërthënë. Kuteli, ngado që sillej, sikur shoqërohej nga kënga popullore dhe për të, kënga ishte ushqimi më i mirë shpirtëror. Prandaj, sa herë i jepej rasti, ai ishte i gatshëm të jepte informacion të mjaftueshëm për këngën. Mjaftoi mbishkrimi i një varri *Këtu pushojnë Balta e Mana Tarabolluzi të mbytur prej Lumjanëve më 2 Tetuer 1880*, që Kuteli e kishte hasur në varrezat e Prizrenit, për ta nxitur atë që të interesohet për historinë e kësaj vrasjeje. Kështu, ai arrin të zbulojë se, për këtë ngjarje dhe për trimërinë e treguar nga Balta e Mana, burrë e grua, populli kishte thurur këngë:

*Mana mush e Balta qit,
I Madhi Zot mos na korit.
Moj Mane, moj kraljicë,
Na kallshe ç'at ditë
Se kan ardh cubat me të mbyte.
Tani shtëpia e tyre është e shkretë. Nuk u mbeti veç se kënga.¹⁶*

Dhe kështu, kënga popullore, për Kutelin, sikur merr kuptimin e një lidhjeje të përhershme në mes të të gjallëve dhe të të vdekurve.

Proza e Mitrush Kutelit është, ashtu si edhe është shkruar, prozë e frymëzuar dhe e shkruar përnjëherë me këngën. Proza e tij kumton bashkërisht me zërin, melodinë dhe me aspiratat e këngës. Mund të thuhet, në fund, ato janë dy, por edhe ajo është një me këngën.

¹⁶ Mitrush Kuteli, «*Në Prizren, midis të gjallëve e të vdekurve*», JETA E RE, Revistë letrare, nr.5, Prishtinë, 1995, f. 664.

Jahir AHMETI

CONTRIBUTION DE MITRUSH KUTELI A LA POESIE POPULAIRE

Résumé

Dans ce travail, la contribution de Mitrush Kuteli dans le domaine de la poésie populaire est traitée sur trois plans: a) collectionneur et éditeur de la poésie populaire; b) re-créateur des récits en exploitant les thèmes et les chansons populaires,

Il a laissé le recueil poétique "Chansons et cris de la ville brûlée" (en 1944) ainsi qu'un certain nombre de travaux manuscrits. Il a présenté ses pensées critiques sur les chansons dans la préface de son recueil. Kuteli se distingue dans la littérature albanaise en tant que narrateur original de la re-création des sujets de chansons populaires, ainsi que dans l'exploitation des vers populaires des récits littéraires.